

Prot. TH2152  
Dt. 11.09.'06



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568  
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

**DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES**  
**Sektori i Licencimit, Rregullimit dhe Standardeve**  
Nr. 4630 Prot.

Tiranë, më 08.09. 2006

Për: **BANKA PROCREDIT**  
**TIRANË**

Lënda: **Dërgohet vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë**

I nderuar zoti Drejtor,

Me anë të kësaj letre, ju njoftojmë se Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 30.08.2006 mori vendimin me nr. 63 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 11.25 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës ProCredit sh.a., nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim tek ProCredit Holding A.G., Gjermani"

Ju lutemi gjeni bashkangjitur vendimin përkatës.

Me respekt

Klodion Shehu  
Drejtor





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 63, datë 30.08.2006

P Ë R

MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PRONËSISË SË 11.25 PËR QIND TË AKSIONEVE NË  
KAPITALIN AKSIONER TË BANKËS PRO CREDIT SH.A., NGA BANKA EVROPIANE PËR  
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM TEK PRO CREDIT HOLDING A.G., GJERMANI

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë  
23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe të rregullores "Për  
dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e  
Shqipërisë" i ndryshuar me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,  
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të japë miratimin për transferimin e pronësisë së 11.25 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës ProCredit sh.a., nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim tek aksioneri egzistues ProCredit Holding A.G., Gjermani.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

  
Ylli Memisha

KRYETARI

  
Ardian Fullani